



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 158, datë 26.12.2019

PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 113, pika 1, shkronjat “c” dhe “ç”, dhe pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja “b”, nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja “f”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative–territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 32, datë 31.12.2013 të Ministrit të Financave “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, me propozim të kryetarit të Bashkisë, këshilli bashkiak,

V E N D O S I :

PJESA I PJESA E PËRGJITHSHME

TITULLI I TAKSAT VENDORE QË APLIKOHEN NË TERRITORIN E BASHKISË TIRANË

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky vendim përcakton llojet e taksave dhe tarifave vendore që zbatohen në territorin e Bashkisë Tiranë, nivelin e taksave dhe tarifave, procedurat e llogaritjes, baza tatimore, kategorizimet dhe nën kategorizimet, lehtësimet apo përjashtimet, arkëtimit dhe transferimit në buxhetin e bashkisë, si dhe detyrimet që kanë agjentët për mbledhjen e taksave dhe tarifave.

Neni 2 **Llojet e taksave**

1. Në Bashkinë Tiranë aplikohen këto taksa vendore:
 - a. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin;
 - b. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
 - c. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
 - d. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël;
 - e. Taksa e fjetjes në hotel;
 - f. Taksa e tabelës;
 - g. Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore.
2. Përjashtohen nga taksat vendore të gjitha subjektet e parashikuara shprehimisht në këtë vendim apo në akte ligjore dhe nënligjore të veçanta.

Neni 3 **Përkufizime**

Për qëllime të zbatimit të taksës së ndërtesës në Bashkinë Tiranë, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agjent i mbledhjes së taksave dhe tarifave” është personi i cili, sipas kërkesave të këtij vendimi, është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogarinë e Bashkisë Tiranë apo strukturave të saj, të të ardhurave nga taksat dhe tarifat.
2. “Pasuri e paluajtshme” janë trualli, toka bujqësore dhe ndërtesat mbi dhe nën tokë, sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.
3. “Kadastra fiskale” është regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme që shërben për qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.
4. “Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifa Vendore”, struktura për administrimin e taksave dhe tarifave vendore pranë Bashkisë Tiranë.
5. “Niveli tregues i taksës” janë nivelet e taksave të parashikuara sipas këtij vendimi.
6. “Çmim vlerësues”, njësia matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar.
7. “Ndërtesë”, objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në vendim.
8. “Ndërtesë e papërfunduar”, objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
9. Njësi pronësore”, ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të një personi fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”. Njësia pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.
10. “Ndarje e njësisë pronësore për banim”, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim banimi.
11. “Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike”, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.

12. “Përdorues”, individ, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/ njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.
13. “Taksë” është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e Bashkisë Tiranë që paguhet nga çdo person apo nëpërmjet një agjenti që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik në territorin e Bashkisë Tiranë.
14. “Tarifë” është pagesa, që një individ, person fizik apo juridik, bën drejtpërdrejt apo nëpërmjet një agjenti tek administrata e Bashkisë Tiranë. Pagesa bëhet në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë.
15. “Taksapagues”, çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, i cili është i detyruar të paguajë njërën nga taksat vendore të përcaktuar në këtë vendim apo legjislacionin në fuqi.
16. “Vlerë e pasurisë”, është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore.
17. “Veprimtari ekonomike”, është çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

KREU II

TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

Neni 4

Taksa mbi pasuritë e paluajtshme

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga:

1. Taksa mbi ndërtesat.
2. Taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa mbi truallin.

Neni 5

Taksa mbi ndërtesën

1. Taksa mbi ndërtesën zbatohet në përputhje me parashikimet dhe përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 132, datë 07.03.2018, “Për metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit, të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve e rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, të ndryshuar, si dhe çdo akti tjetër që normon këtë proces.
2. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në ligj përcaktohen ndryshe.
3. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.
4. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

5. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
6. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit.

Neni 6

Çmimi mesatar referues për përlllogaritjen e taksës

1. Çmimi mesatar referues i shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi, për Bashkinë Tiranë është sipas tabelës Aneksit nr. 1, bashkëngjitur dhe pjesë e përbërëse e këtij vendimi.
- 1.1. Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit, vetëm në rastin e shitjes së parë.
2. Çmimet mesatare për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ndërtesat që nuk shërbejnë për banim në territorin e Bashkisë Tiranë, janë si më poshtë:
 - a. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi, për Bashkinë Tiranë, është 2 (dy) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit, sipas Njësive Administrative. Në këtë kategori do të përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë.
 - b. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit, sipas Njësive Administrative.
 - c. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit, sipas Njësive Administrative.
 - d. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse.
 - e. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.

Neni 7

Shkalla e taksës mbi ndërtesat

1. Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është:
 - a. 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
 - b. 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
 - c. 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
3. Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës, të përcaktuar në aktin e lejes së ndërtimit apo aktin e regjistrimit pranë regjistrave të pasurive të paluajtshme:
 - a. Apartamente banimi do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim”.

- b. Njësi biznesi do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike”.
 - c. Bodrum/parking i mbuluar do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “ndërtesa që përdoret për parkim të mbuluar dhe bodrume”.
4. Kur nga verifikimi në terren rezulton se ndërtesa apo njësi të veçanta të saj janë vënë në përdorim/shfrytëzim, pavarësisht se ndërtesa në tërësi nuk ka përfunduar, taksa llogaritet e plotë për pjesën në përdorim/shfrytëzim. Në këtë rast, baza e taksueshme llogaritet me kostot e ndërtimit për pjesën e papërfunduar dhe me çmimet vlerësuese për pjesët e vëna në përdorim. Për pjesë të ndërtesës të vëna në përdorim, baza e taksës do të jetë e plotë. E njëjta situatë vlen edhe kur nuk është dhënë leja e shfrytëzimit të ndërtesës apo nuk është bërë regjistrimi në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.
5. Sipërfaqja e prezumuar.
- Për ndërtesat që përdoren, shfrytëzohet për banim, identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:
- a. 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;
 - b. 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuar me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar.
6. Për sa i përket kategorisë, ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe/ose agjenti tatimor i caktuar nga Bashkia Tiranë bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës.

Neni 8

Lehtësira dhe përjashtimet nga taksa e ndërtesës

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

1. Pronat e shtetit dhe të njësive të Bashkisë Tiranë që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
2. Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore.
3. Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
4. Banesat sociale në pronësi të Bashkisë Tiranë,
5. Pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me Bashkinë Tiranë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale.
6. Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
7. Strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”.
8. Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët. Për efekt të përfitimit nga përjashtimi mbi taksën e ndërtesës, kryefamiljari duhet të ketë mbushur moshën dhe përfituar pagesën e pensionit.
9. Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike.
10. Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore.

11. Taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore, sipas vendimeve rast pas rasti nga këshilli bashkiak, në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind.

Neni 9

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së ndërtesës

1. Struktura e Bashkisë Tiranë e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.
2. Agjent Tatimor i ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për qëllime banimi në Bashkinë e Tiranës është shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sha.
3. Në rolin e agentit tatimor, shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sha, përfiton një komision prej 5 % të shumës së arkëtuar.

Neni 10

Verifikimi i subjekteve që përjashtohen nga taksa e ndërtesës

1. Strukturat e ngarkuara për verifikimin e subjekteve që përjashtohen nga pagesa e taksës për kategorinë e subjekteve familjarë janë Njësitë Administrative dhe Lagjet e Bashkisë Tiranë.
2. Listat me subjektet e përjashtuara, pasi hartohen nga njësitë administrative dhe lagjet, i njoftohen çdo muaj Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Agjentit Tatimor dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar.

Neni 11

Dokumentacioni që dorëzohet për të përfituar përjashtimi nga taksa e ndërtesës

1. Subjektet familjarë që përjashtohen sipas nenit 8, të këtij vendimi, depozitojnë pranë Njesisë Administrative/Lagjes ku kanë vendbanimin, dokumentacionin përkatës që vërteton se:
 - a. marrin pension pleqërie/pension social;
 - b. janë kryefamiljarë që kanë në përbërje të familjes vetëm pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre të paaftë për punë;
 - c. trajtohen me ndihmë ekonomike;
 - d. kopje të dokumentit ku banojnë që provon se janë pronarë apo përdorues të pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës etj;
 - e. kopje të kontratës/ librezës/ faturës së abonentit kryefamiljar që bën kërkesën për përjashtim.

Neni 12

Mënyra e pagesës

1. Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.
2. Për kategorinë e ndërtesave që shfrytëzohen për banim, detyrimi paguhet në 12 këste të barabarta, për çdo muaj përkatësisht nga çdo familje. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit. Likuidimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit.
3. Për kategoritë e ndërtesave që përdoren për veprimtari ekonomike, detyrimi paguhet me 2 këste:
 - a. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 Prill
 - b. Kësti i dytë brenda datës 30 Qershor.
4. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Qershor, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

KREU III

TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Neni 13

Baza dhe llogaritja e detyrimit

1. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë pronësinë.
2. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar.
3. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.
4. Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, njihen dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në rast mungese të dokumentacionit ligjor verifikimi bëhet nga komisioni i verifikimit të pasurive të paluajtshme i ngritur për këtë qëllim.

Neni 14

Komisioni i verifikimit

Kryetari i Bashkisë ngre komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme për tokën bujqësore. Komisioni verifikon vërtetësinë e vetëdeklarimit të sipërfaqes së tokës bujqësore të dorëzuar nga subjekti taksapagues.

Neni 15

Niveli i taksës

1. Niveli i taksës mbi tokën bujqësore sipas kategorive është sipas tabelës Aneksi nr.2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e Ministrisë që mbulon çështjet e bujqësisë.

Neni 16

Lehtësira dhe përjashtime

1. Aplikohet një zbritje prej 30 % e taksës për tokat bujqësore, për të gjitha sipërfaqet e shfrytëzuara për qëllime bujqësore.
2. Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Neni 17

Struktura për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore

1. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë së Tiranës, në bashkëpunim me njësinë/lagjen administrative përkatëse.
2. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës dhe bashkëpunimi me Njësitë Administrative dhe lagjet rregullohet me rregullore të veçantë të miratuar nga kryetari i Bashkisë Tiranë.

KREU IV TAKSA MBI TRUALLIN

Neni 18

Baza dhe niveli i taksës mbi truallin

1. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metra katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.
2. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror në vit. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, janë si më poshtë:
 - a. Vlera e taksës në lekë/m²/vit për qëllime banimi nga individët, është 0.56 lekë për m² në vit;
 - b. Vlera e taksës në lekë/m²/vit, për qëllime biznesi është 20 lekë për m² në vit.
3. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim.

Neni 19

Struktura për vjeljen e taksës mbi truallin

1. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë së Tiranës në bashkëpunim me Njësinë/lagjen Administrative përkatëse.
2. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës dhe bashkëpunimi me Njësitë/lagjen Administrative rregullohet me rregullore të veçantë të miratuar nga kryetari i Bashkisë Tiranë.

KREU V TAKSA MBI KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Neni 20

Baza, niveli dhe llogaritja e detyrimit

1. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.
2. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
3. Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
4. Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre.
5. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
6. Niveli i taksës sipas kategorive, është sipas tabelës Aneksi nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Neni 21

Përfashtimet nga taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë

1. Përfashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:
 - a. Enti Kombëtar i Banësive, ministria përgjegjëse për financat dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore.
 - b. Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar;
 - c. Subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
 - (i) institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
 - (ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak apo struktura e deleguar nga ky i fundit për përfashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

Neni 22

Agjenti tatimor

1. Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
2. Në rolin e agjentit tatimor, Agjencia Shtetërore e Kadastrës përfiton një komision prej 3 % të shumës së arkëtuar.

KREU VI

TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Neni 23

Baza dhe niveli i taksës

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
2. Niveli i taksës në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave.
3. Në rastin e ndërtimeve, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe:
 - a) për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individit apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 4 për qind të vlerës së investimit;
 - b) për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, të aeroporteve, të

tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit;

c) për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi;

d) për ndërtesat, që destinohen për qëllime banimi në zonat malore, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 3 për qind e vlerës së investimit, sipas vendimeve të këshillit bashkiak për përcaktimin e zonave malore për efekt të zbatimit të këtij paragrafi.

4. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të Bashkisë Tiranë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

Neni 24

Mënyra dhe afati i pagesës së taksës

1. Taksa paguhet dhe ngarkohet në sistemin elektronik të lejeve brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së vendimit për miratimin e lejes së ndërtimit dhe lëshimit të autorizimit të pagesës nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Nëse në përfundim të këtij afati kërkuesi nuk ka paguar dhe ngarkuar aktet që provojnë pagimin e taksës, autoriteti përgjegjës i dërgon kërkuesit, nëpërmjet sistemit elektronik, vendimin për refuzimin e lejes së ndërtimit”.

2. Taksa paguhet nga individ/subjekti i interesuar në çdo moment dhe gjithsesi jo më vonë se 45 ditë nga data e dhënies së lejes së legalizimit nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Nëse subjekti/personi i interesuar nuk kryen pagesën brenda këtij afati, atëherë për çdo ditë vonësë i llogaritet kamatë 0,1 për qind në ditë e shumës që duhet të paguajë, deri në 30 ditë pune.

3. Për kategoritë ku niveli i taksës aplikohet mbi vlerën e investimit, në përfundim të punimeve të kryera sipas lejes së miratuar, bëhet kontrolli i pagesave me situacionin përfundimtar të objektit të ndërtuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe nëse ka diferenca mes vlerës së investimit sipas situacionit përfundimtar dhe preventivit, njoftohet subjekti për vlerën e diferencës që është i detyruar të shlyejë. Mosshlyerja e këtij detyrimi përbën shkak për pezullimin e procedurave të pajisjes me leje përdorimi të subjektit.

Neni 25

Struktura për përlllogaritjen dhe vjeljen e taksës

1. Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe të ardhurat arkëtohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

2. Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat në proces legalizimi është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Neni 26

Përjashtimi nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

1. Përjashtohen nga detyrimi i pagesës së kësaj takse:

a. ndërtimet e reja për shoqëritë me kapital të zotëruar nga Bashkia e Tiranës në masën 100% dhe ndërmarrjet e Bashkisë Tiranë për të gjitha ndërtimet e reja apo ndërhyrjet reabilituese në infrastrukturën ku investitor apo përfitues i një projekti të financuar nëpërmjet marrëveshjeve, granteve apo huave janë këto të fundit;

- b. investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”;
- c. investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

KREU VII

TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Neni 27

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël

Sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, çdo biznes, i cili realizon gjatë vitit një qarkullim më të vogël ose të barabartë me 8,000,000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Neni 28

Baza dhe niveli i detyrimit

1. Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë.
2. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, paraqitet si më poshtë vijon:
 - a) niveli i tatimit për subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim vjetor nga 0 deri në 5 milionë lekë, është 0 (zero) lekë.
 - b) shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me qarkullim nga 5 deri në 8 milionë lekë, është 5 për qind mbi fitimin e tatueshëm.

Neni 29

Mënyra e pagesës

Tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e administratës tatimore ose në Postën Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës:

- a. 20 prill të çdo viti, për muajt janar, shkurt e mars;
- b. 20 korrik të çdo viti, për muajt prill, maj e qershor;
- c. 20 tetor, për muajt korrik, gusht e shtator;
- d. 20 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor.

Neni 30

Struktura për vjeljen e taksës

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogarinë e buxhetit të Bashkisë Tiranë të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.
2. Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të Bashkisë Tiranë, brenda datës 10 të muajt pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet dhe për shërbimin që kryen merr një komision, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.
3. Struktura përgjegjëse për kryerjen e akt akordimeve me Drejtorinë Rajonale Tatimore është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

KREU VIII

TAKSA E FJETJES NE HOTEL

Neni 31

Baza dhe niveli i detyrimit

1. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara ne hotel. Janë subjekt i taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie.
2. Për subjektet “Hotele me 4 dhe 5 yje” që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Tiranës, niveli i taksës për çdo fjetje është 350 lekë për person, ndërsa për ato që ushtrojnë aktivitetin e tyre në njësitë administrative jashtë qytetit të Bashkisë Tiranë, vlera që duhet të paguhet është 105 lekë për natë fjetje për person.
3. Subjektet “Hotel nën 4 yje”, motel, hostel, bujtinë, si dhe çdo njësi tjetër akomoduese të ngjashme me to, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Tiranës, niveli i taksës është 140 lekë për person, ndërsa për subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre në njësitë administrative jashtë qytetit të Tiranës, vlera që duhet të paguhet është 35 lekë për natë fjetje për person.
4. Për kategorinë e subjekteve të cilat deklarojnë me orë pushimi deklarimi deri në tre pushime në ditë të konsiderohet i barasvlershëm me një natë fjetje.

Neni 32

Struktura për vjeljen e taksës

1. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes ne hotel është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë së Tiranës në bashkëpunim me njësitë administrative dhe lagjet.
2. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës dhe bashkëpunimi me njësitë administrative dhe lagjet rregullohet me rregullore të veçantë të miratuar nga kryetari i Bashkisë Tiranë.
3. Mënyra e deklarimit dhe raportimit për operatorët ekonomikë që janë subjekt i taksës së fjetjes në hotel, kryhet nëpërmjet sistemit elektronik të qendëruar të ngritur nga Bashkia Tiranë.

KREU IX

TAKSA E TABELËS

Neni 33

Fusha e zbatimit dhe kategorizimet

1. Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.
2. Për qëllime të zbatimit të këtij vendimi, tabelat kategorizohen në:

a) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logoja dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një table identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.

b) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

c) Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose joballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si: tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, për të tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

ç) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

3. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

4. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga shkronja të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si: mur, fasadë e jashtme e çdo lloji, shtyllë, kolonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë e shkruar, e stampuar apo e pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zënë të gjitha shkronjat, figurat, logot dhe simbolet që formojnë tabelën.

Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe shkronja, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produkteve apo shërbimeve që furnizohen nga vetë njësia, ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori table. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.

Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një table identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori table.

Neni 34

Niveli i taksës

Nivelet e taksës së tabelës, sipas kategorizimeve të përcaktuara në nenin 33, jepen në Aneksin nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Neni 35

Lehtësira

Për bizneset e krijuara të reja, afati i pagesës së detyrimit është brenda 3 muajve nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

KREU X

TAKSA E PËRKOHSHME PËR INFRASTRUKTURËN ARSIMORE

Neni 36

Subjektet dhe niveli taksës

1. Taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore i nënshtrohen të gjitha familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike, në njësi fikse të palëvizshme, brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.
2. Niveli i taksës së përkohshme të infrastrukturës arsimore, sipas kategorive dhe nënkategorive është sipas Aneksit nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Neni 37

Mënyra e pagesës

1. Detyrimi për taksën e përkohshme për infrastrukturën arsimore është vjetor. Kjo taksë aplikohet për një periudhë 7-vjecare nga data e miratimit të saj, sipas vendimit nr. 59/2015 të këshillit bashkiak.
2. Për kategorinë I “Familjarët” detyrimi paguhet në 12 këste të barabarta, për çdo muaj përkatësisht në shumën 150 lekë për çdo familje. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit. Likuidimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit.
3. Për kategorinë II. “Biznesi” detyrimi paguhet brenda datës 20 Prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

Neni 38

Lehtësira dhe përjashtime

1. Në kategoritë e përjashtuara nga pagesa e taksës së përkohshme e infrastrukturës arsimore, përfshihen pensionistët, veteranët, invalidët e punës e luftës, përfituesit e ndihmës ekonomike, të verbrit, të sëmurët tetraplegjik dhe paraplegjikë, si dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuar, sipas përkufizimit të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
2. Kategoritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, për të përfituar këtë përjashtim, duhet të dorëzojnë pranë zyrave të Njësive Administrative dhe Lagjeve të Bashkisë së Tiranës:
 - a. Dokumentin që vërteton kushtin që sipas certifikatës familjare janë kryefamiljarë dhe pa persona të tjerë madhorë përveç bashkëshortit ose bashkëshortes, si dhe personave të tjerë madhorë të paaftë për punë (invalidë ose fëmijë nën 25 vjeç që ndjekin studimet).
 - b. Librezën e veteranit ose invalidit të luftës, statusin e invalidit të punës e të luftës, statusin e të verbrit, të sëmurëve paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit, vërtetimin e KMCAP, vërtetimin nga Njësia Administrative/lagjet për përfituesit e ndihmës ekonomike.
3. Nga taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore, përjashtohen administratorët e pallateve dhe individët fermerë.
4. Nga taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore përjashtohen edhe të gjithë niptet sekondare të regjistruara nga subjektet taksapagues për efekt të detyrimeve tatimore apo sigurimeve shoqërore dhe që nuk janë njësi fikse dhe të palëvizshme.

Neni 39
Mënyra e përlllogaritjes

1. Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer, përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

TITULLI II

TARIFAT VENDORE

Neni 40
Llojet e tarifave

1. Bashkia Tiranë aplikon tarifat vendore si më poshtë:
 - a. Tarifa e pastrimit;
 - b. Tarifa e parkimit të automjeteve;
 - c. Tarifa për zënien e hapësirave publike;
 - d. Tarifa për dhënie licence për tregtim karburanti e lëndë djegëse;
 - e. Tarifa e shërbimit veterinar;
 - f. Tarifa të shërbimit administrativ të Bashkisë Tiranë;
 - g. Tarifë për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime;
 - g. Tarifa të institucioneve të varësisë.

KREU I

Neni 41
Tarifa e pastrimit

1. Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.
2. Niveli i kësaj tarife dhe kategoritë përcaktohen në Aneksin nr. 6, bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 42
Mënyra e pagesës së tarifës së pastrimit

1. Detyrimi për tarifën e pastrimit është vjetor.
2. Për kategorinë I “Familjarët” detyrimi paguhet në 12 këste mujore. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit. Likuidimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit”.
3. Për kategorinë I “Familjarët” detyrimi llogaritet dhe paguhet për familje. Për të llogaritur detyrimin për tarifën kjo kategori duhet të paraqesë pranë agjentit tatimor përkatës certifikatën e gjendjes familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile.
4. Për kategorinë II. “Biznesi” detyrimi paguhet brenda datë 20 Prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

5. Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer, përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal).

6. Për kategorinë II. “Subjekte Ndërtimi” nënkategorinë “Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, etj të ngjashëm me to” “Rikonstruksione të pjesshme për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla kopshte, objekte banimi e tregtare, etj të ngjashëm me to”, llogaritja e tarifës së pastrimit të fillojë me zbardhjen e lejes së ndërtimit deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për leje shfrytëzimi pranë Bashkisë së Tiranës. Këtu përjashtohen kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i Bashkisë apo buxheti i shtetit.

7. Të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo tarifë.

8. Përjashtimisht, për bizneset e reja të krijuara, afati i pagesës së detyrimit është brenda 3 muajve nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

9. Agjenti tatimor i ngarkuar për mbledhjen e tarifës së pastrimit për kategorinë “Familjarë” është shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a, duke përfituruar 5 % të shumës së arkëtuar, ndërsa për të gjithë subjektet e tjera, struktura e ngarkuar është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Neni 43

Lehtësira dhe përjashtime

1. Kategoritë e përjashtuara nga pagesa e tarifës së pastrimit, ku përfshihen pensionistët, veteranët, invalidët e punës e luftës, përfituesit e ndihmës ekonomike, të verbrit, të sëmurët tetraplegjik dhe paraplegjikë, si dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuar sipas përkufizimit të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Për të përfituruar nga ky përjashtim, individët duhet të dorëzojnë pranë zyrave të Njësi Administrative dhe lagjeve, dëshminë e gjendjes së tyre:

a) dokumentin që vërteton kushtin që të jenë kryefamiljarë dhe pa persona të tjerë madhorë përveç bashkëshortit ose bashkëshortes, në certifikatën familjare, si dhe persona të tjerë madhorë të paaftë për punë (invalidë ose fëmijë nën 25 vjeç që ndjekin studimet);

b) librezën e veteranit ose invalidit të luftës, statusin e invalidit të punës e të luftës, statusin e të verbrit, të sëmurëve paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit, vërtetimin e KMCAP, vërtetimin nga Njësia Administrative ose lagja për përfituesit e ndihmës ekonomike.

2. Përjashtohen nga tarifa e pastrimit administratorët e pallateve në Tiranë dhe individët fermerë.

KREU II

TARIFA E PARKIMIT TË AUTOMJETEVE

Neni 44

Fusha e zbatimit dhe mënyra e pagesës

1. Tarifa e parkimit të automjeteve është detyrim i çdo individi i cili parkon në vendet e miratuara si “Parkim me pagesë”.

2. Të ardhurat e gjeneruara nga Tirana Parking kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës. Të ardhurat xhirohen në llogarinë e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës, dhe Tirana Parking kryen çdo muaj akt-rakordimet me Degën e Thesarit dhe raporton në Bashkinë e Tiranës.

3. Shërbimi i parkimit administrohet nga Tirana Parking, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë.

4. Zonat e Administrimit të Parkimit në qytetin e Tiranës dhe tarifatat përkatëse të parkimit të automjeteve përcaktohen sipas Aneksit nr.7 bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 45

Përrjashtimet nga tarifa e parkimit

1. Zonat të cilat përrjashtohen nga parkimi me pagesë janë ato të rezidentëve, të cilët duhet të pajisen me kartën e rezidentit, zona të cilat nuk kanë sinjalistikë të parkimit me pagesë dhe zonat të cilat janë të rezervuara për persona me aftësi të kufizuar (PAK).
2. Gjithashtu përrjashtim nga pagesa e parkimit përrfitohet gjatë ditëve të pushimit (fundjavë) në zona që është miratuar parkimi nga e hëna – të premte. Të gjitha zonat e parkimit në rrugë pas orës 20⁰⁰ deri në 07³⁰ janë të lira pa pagesë vetëm në rastet e parkimeve të rezervuara apo me orar 24 orë.

Neni 46

Format e pagesës

Tarifa e parkimit të automjeteve paguhet nëpërmjet formave të mëposhtme:

- a) pranë agjentit në terren
- b) nëpërmjet SMS nga telefoni
- c) pagesave mujore/vjetore të bëra me rezervim
- d) nëpërmjet mënyrave alternative të pagesës të përcaktuara me akte nënligjore.

KREU III

TARIFA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

Neni 47

Baza dhe niveli i tarifës

1. Baza e tarifës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në metër katror, e cila kërkohet të shfrytëzohet nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi.
2. Niveli i tarifës sipas kategorive dhe nënkategorive është sipas aneksit nr. 8, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Detyrimi i tarifës për llogaritë si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelet treguese të saj.
4. Pagesa e tarifës për zënie të hapësirës publike:
 - a. Për rastin e përdorimit të truallit me qëllim organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme, struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, pas marrjes së lejes për ushtrimin e aktivitetit në hapësirë publike, nga struktura përkatëse që jep këtë leje në Bashkinë e Tiranës. Kjo strukturë kryen dhe llogaritjen e detyrimit për lejen përkatëse.
 - b. Për rastin e përdorimit të truallit qëllim ushtrim aktiviteti tregtar në Tregjet Publike të Tiranës, detyrimi është mujor dhe pagesa do të bëhet brenda datës 30 të muajit përkatës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore”, në bashkëpunim me Njësinë Administrative përkatëse. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës dhe bashkëpunimi me Njësitë Administrative dhe lagjet rregullohet me rregullore të veçantë.
 - c. Për rastin e përdorimit të truallit me qëllim ushtrim aktiviteti tregtar si vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, sipërfaqet e zëna me platforma, sipërfaqet e rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to, detyrimi është mujor dhe pagesa do të bëhet brenda datës 30 të muajit përkatës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Neni 48

Lehtësira dhe përrjashtime

1. Subjektet që lidhin kontratë për zënie të hapësirës publike me afat 6-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 5% të vlerës së detyrimit.
2. Subjektet që lidhin kontratë për zënie të hapësirës publike me afat 12 mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 10% të vlerës së detyrimit.
3. Përfshihet nga tarifa e zënies së hapësirës publike Bashkia Tiranë dhe institucionet e saj të varësisë, kur kjo hapësirë shfrytëzohet në përmbushjen e funksioneve të tyre publike.

Neni 49

Struktura për mbledhjen e tarifës së hapësirës publike

1. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës për zënien e hapësirës publike është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, në bashkëpunim me njësitë administrative dhe lagjet e Bashkisë Tiranë.
2. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës dhe bashkëpunimi me njësitë administrative dhe lagjet e Bashkisë Tiranë rregullohet me rregullore të veçantë.

KREU IV

Tarifa për dhënie licence për tregtim karburanti e lëndë djegëse

Neni 50

Baza dhe niveli i tarifës

1. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë.
2. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
3. Vlera e pagesës sipas këtij neni është për një periudhë pesë vjeçare.
4. Të ardhurat, që realizohen nga pagesat e tarifave, përdoren në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, sipas përcaktimeve përkatëse.

Neni 51

Agjenti Tatimor

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës për dhënie dhe përsëritjen e licencës për tregtim karburanti, lëndë djegëse e vajra lubrifikantë është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, pas marrjes së Lejes për Ushtrimin e Aktivitetit, nga struktura përkatëse që lëshon lejet për ushtrim aktiviteti në Bashkinë e Tiranës.

KREU V

TARIFA E SHËRBIMIT VETERINAR

Neni 52

Kategoritë dhe niveli i tarifës

1. Bashkia Tiranë është përgjegjëse për mbledhjen e tarifës së shërbimit veterinar në territorin e saj.
2. Tarifa është një detyrim fikse që aplikohet nga shërbimi veterinar për të gjithë kategoritë, si më poshtë:
 - a) subjekte me aktivitet thertore;
 - b) subjekte me aktivitet pikë therje;
 - c) treg i gjësë së gjallë.
3. Niveli i tarifave të shërbimit veterinar përcaktohet në aneksin 9 bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 53
Lehtësira dhe përjashtime

1. Për kategorinë 1 (gjedh i rritur, gjedh i ri (lopë, ka, mëshqerrë, viç), për thertoret e organizuara në komplekse, ku theken mbi 100 krerë në muaj, niveli i tarifës është 100 lekë/krerë.
2. Për kategorinë 2 (dash, dele, çjap, dhi, derr, rurza, milorë, ftuja, tujak, qengj, keç, gic), për thertoret e organizuara në komplekse, ku theken mbi 100 krerë në muaj, niveli i tarifës të jetë 50 lekë/krerë.

Neni 54
Agjenti Tatimor

Tarifat e shërbimit veterinar arkëtohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë në bashkëpunim me Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorit.

KREU VI
TARIFA TË SHËRBIMIT ADMINISTRATIV TË BASHKISË TIRANË

Neni 55

**Tarifa e shërbimit të dhënies së informacionit dhe shfrytëzimit të dokumenteve që prodhon
Bashkia Tiranë**

1. Kërkesat e personave fizikë dhe/ose juridikë, publikë ose privatë për dhënie informacioni dhe/ose vënie në dispozicion të dokumenteve të prodhuara nga aparati dhe institucionet në varësi të Bashkisë Tiranë, plotësohen kundrejt tarifave të përcaktuara në këtë nen.
2. Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit dhe/ose dokumentacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, edhe e dërgimit të tij.
3. Tarifat për dhënien e informacionit dhe/ose vënies në dispozicion të dokumenteve që prodhohen nga Bashkia Tiranë, janë si më poshtë:
 - a. 1 deri në 10 fletë fletë, informacioni përfitohet pa pagesë;
 - b. Fotokopje bardhë e zi, Format A4: 11-100 fletë = 9 lekë/copa, mbi 100 fletë = 5 lekë/copa
 - c. Printime bardhë e zi, Format A4: 11-100 fletë = 9 lekë/copa, mbi 100 fletë = 5 lekë/copa
 - d. Fotokopje bardhë e zi, Format A3: 11-100 fletë = 15 lekë/copa, mbi 100 fletë = 12 lekë/copa
 - e. Printime bardhë e zi, Format A3: 11-100 fletë = 15 lekë/copa, mbi 100 fletë = 12 lekë/copa
 - f. Printime me ngjyra: 11-100 fletë = 20 lekë/copa, mbi 100 fletë = 10 lekë/copa
 - g. Skanime: 11-50 skanime = 25 lekë/copa, 51-100 skanime = 20 lekë/copa, mbi 100 skanime = 10 lekë/copa
 - h. Tarifa e CD-së 50 lekë

Neni 56
Procedura për vjeljen e kësaj tarife

1. Struktura përkatëse që do t'i kërkojë informacioni dhe që do të bëjë riprodhimin e dokumenteve të kërkuara, duhet të japë informacionin, sipas pikës 1, të nenit 55, të këtij vendimi për dokumentet që ka prodhuar, duke i dorëzuar ato pranë Koordinatorit për të drejtën e informimit. Koordinatori për të drejtën e informimit vijon procesin duke dorëzuar pranë personit të caktuar si përgjegjës për lëshimin e mandat-arkëtimit/faturës së arkëtimit.

2. Pagesa e tarifës në vlera më të vogla se 1,000 (një mijë) lekë mund të bëhet pranë arkës së institucionit përkundrejt një mandat arkëtimi dhe më pas personi përgjegjës e kalon këtë të ardhur në llogari të buxhetit të Bashkisë Tiranë. nëpërmjet një banke të nivelit të dytë.
3. Tarifa mbi vlerën 1,000 lekë duhet të paguhet në bankat e nivelit të dytë, duke tërhequr më parë pranë dy kopje të faturës së arkëtimit, të miratuar nga Ministria e Financave, ku përfshihet Kodi i Institucionit dhe Kodi i të ardhurave.
4. Materialet e riprodhuara i dorëzohen kërkuarit pas paraqitjes së mandat arkëtimit pranë Koordinatorit për të drejtën e informimit.
5. Kërkuari nuk duhet të shumëfishojë për qëllime shitje informacionin dhe/ose dokumentacionin e marrë sipas këtij vendimi.
6. Publikimi i tarifave të përcaktuara në pikën 3, të nenit 55, bëhet në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë, si dhe në ambientet e pritjes me publikun.

Neni 57

Lehtësira dhe përjashtime

1. Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike jepet falas.
2. Personat që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe subjektet përfituese sipas ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, për çështje që kanë të bëjnë me interesat e tyre, e përfitojnë informacionin dhe/ose dokumentacionin falas, pas vërtetimit të statusit përkatës.

KREU VII

TARIFA PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PUNIME

Neni 58

Baza, niveli dhe përlllogaritja e tarifës

1. Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për leje punimesh do të paguhet për çdo aplikim për leje zhvillimi, infrastrukture dhe ndërtimi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.
2. Për leje zhvillimi tarifa llogaritet në bazë të sipërfaqes së zonës që do të zhvillohet. Niveli i tarifës është në vlerën 10 (dhjetë leke) për metër katror dhe depozitohet për llogari të Bashkisë Tiranë.
3. Për leje ndërtimi tarifa është në vlerën 1 për qind e vlerës së investimit. Vlera e investimit llogaritet sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga Enti Kombëtar i Banësive ose preventivin e investimit të paraqitur nga subjekti i interesuar dhe përzgjidhet vlerën më të lartë midis të dyjave.
4. Përjashtohet nga pagesa e kësaj tarife Bashkia e Tiranës në rolin e investitorit të objekteve publike.
5. Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifat e urbanistikës është Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe arkëtimi kryhet sipas autorizimit të lëshuar për këtë qëllim, pranë bankave të nivelit të dytë ose pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore. Mandati i pagesës ngarkohet në sistemin elektronik E-Leje.

KREU VIII

TARIFA TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË

Neni 59

Tarifa për Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, aplikon këto tarifa:

1. Hyrja në Kopshtin Zoologjik, për fëmijë është 50 lekë dhe për të rriturit 100 lekë

2. Për dhënie në përdorim të ambienteve të Amfiteatrit 10.000 lekë/ora;
3. Tarifat për dhënie në përdorim të ambienteve të “Reja-s” për aktivitete biznesi (edukative, kulturore dhe artistike) 20,000 lekë/ora për aktivitete biznesi; 5,000 lekë/ora për aktivitete edukative, kulturore dhe artistike.
4. Çmimi i biletës për trenin Panoramik, për fëmijët e moshës 0 -15 vjeç është 50 lekë dhe për fëmijët e moshës mbi 15 vjeç është 100 lekë.
5. Çmimi i biletës për varkën vozitëse në liqeni 500 lekë/ora;
6. Për përdorimin e ambienteve të godinave të Tirana Olimpik Park nga personat e tretë niveli i tarifave është si më poshtë:
 - a. Aktivitete të ndryshme sportive në sallën e pallatit të sportit, 12.000 lekë/ora.
 - b. Aktivitete të ndryshme sportive për grupe të rinjsh në sallën e pallatit të sportit 10.000 lekë/ora
 - c. Aktivitete të ndryshme sportive për grupe amatorë/shkolllore jopublike, 9.000 lekë/ora.
 - d. Aktivitete të ndryshme sportive mbi një ditë, 100.000 lekë/dita
 - e. Organizime të ndryshme fetare, kulturore, politike në sallën e pallatit të sportit, 120.000 lekë/dita.
 - f. Aktivitete të ndryshme të organizuara në hollin e pallatit të sportit, 30.000 lekë/dita
 - g. Salla e konferencave, 15.000 lekë/aktiviteti paradite.
 - h. Salla e konferencave, 20.000 lekë/aktiviteti pasdite.
 - i. Salla e konferencave për një ditë, 25.000 lekë/dita.
7. Tarifat e sipërpërmendura do të aplikohen vetëm në rastet e përdorimit nga ekipet sportive; akademitë sportive për fëmijë, të rinj dhe të rritur si dhe shoqata të ndryshme sportive.
8. Tarifat për dhënie në përdorim të fushave sportive në Parkun e Madh të Liqenit Artificial janë:
 - a. Fusha e futbollit, 4000 lekë/ora (me ndriçim);
 - b. Fusha e futbollit, 2000 lekë/ora (pa ndriçim);
 - c. Fusha e basketbollit, 1200 lekë/ora;
 - d. Fusha e volejbollit, 1500 lekë/ora

Neni 60

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarife është Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit dhe sipas akt akordimeve në fund të çdo muaji, të konfirmuara nga Dega e Thesarit, të ardhurat kalojnë 100% në llogarinë e Bashkisë së Tiranës.

Neni 61

Lehtësira dhe përjashtime

1. Përjashtohen nga detyrimi për të paguar çmimin e biletës për Trenin Panoramik, fëmijët me aftësi të kufizuar.
2. Fushat multisportive janë pa pagesë për publikun.
3. Nuk aplikohen tarifa për aktivitetet sociale me interes publik në Fushat Multisportive, Teatri Veror dhe Reja, në rastet e bashkëpunimit ose organizime të APR me të tretë ose nisma të Bashkisë Tiranë, Ente arsimore publike, Evente nga subjekte me mision bamirësie ose individe me aftësi të kufizuara apo nën përkrahje sociale (kur kjo vërtetohet me anë të një kërkesë me objekt: zhvillim aktiviteti social me interes publik nga subjekti organizues)”
4. Për shërbimet në fushat e futbollit, studentët tarifohen 50% të pagesës, me detyrimin të paraqesin kartën e studentit.

Neni 62

Tarifat e shitjes së bimësisë

1. Tarifat e shitjes së bimësisë nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, aplikohen sipas aneksit nr.10 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Tarifa për shitjen e drurëve të zjarrit është 7 000 lekë për metër kub.

Neni 63

Tarifa për Qendrën Kulturore “Tirana”

Qendra Kulturore “Tirana” aplikon këto tarifa:

1. Dhënia në përdorim e sallës së Qendrës Kulturore, 10.000 lekë/ora.
2. Çmimi i biletave për shfaqjet teatrore për të rriturit është 500 lekë /person dhe 300 lekë për personat mbi 65 vjeç.
3. Çmimi i biletës për studentet, shoqëruar me paraqitjen e kartës së studentit është 300 lekë për student.
4. Çmimi i biletave për koncerte, 1000 lekë/person.
5. Çmimi i biletave për shfaqjet teatrore të rinjve, 200 lekë/ person
6. Çmimi i biletave për shfaqjet e fëmijëve, është 100 lekë/ person.
7. Karta e publikut kushton 3000 lekë/person. Karta është e vlefshme për një vit dhe përfshin:
 - a. 1.500 lekë shfaqje të rriturish
 - b. lekë shfaqje koncert;
 - c. 200 lekë shfaqje të rinjsh;
 - d. 300 lekë shfaqje fëmijësh.
 - e. 1 ftesë çift për një nga projektet dhe 1 ftesë për një person për shfaqje të rriturish
8. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Qendra Kulturore “TIRANA”. Të ardhurat kalojnë 100% në llogarinë e Bashkisë së Tiranës, sipas akt akordimeve në fund të çdo muaji, të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Neni 64

Tarifa për kopshtet dhe çerdhet

1. Fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet në Bashkinë e Tiranës, paguajnë një tarifë ditore si më poshtë:
 - a. 160 lekë për fëmijë në kopshte;
 - b. 130 lekë për fëmijë në çerdhe.

Neni 65

Përlllogaritja e detyrimit

1. Detyrimi mujor përbëhet nga tarifa për ushqimin, e cila përlllogaritet me nivelin ditor të tarifës dhe ditët e frekuentimit të fëmijës në çerdhe apo kopsht gjatë një muaji.
2. Për fëmijët e regjistruar për herë të parë kryhet një pagesë paraprake në shumën prej 5 000 lekë, në formën e garancisë. Kjo shumë i rikthehet familjeve me përfundimin e periudhës së trajtimit në këto institucione dhe pasi janë kryer verifikimet se nuk kanë detyrime të papaguara.

Neni 66

Lehtësira dhe përjashtime

Përfitojnë shërbim pa pagesë familjet në nevojë me përbërje:

1. Fëmijë me statusin e jetimit.
2. Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit.
3. Fëmijë me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor.
4. Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike apo me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor.
5. Fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihma ekonomike.

6. Fëmijë të familjeve mono prindërore, ku kujdestari ligjor e ka pagën në/nën niveline pagës minimale të miratuar me aktin nënligjor përkatës.
7. Fëmijët e familjeve, ku kujdestari ligjor i fëmijës, është i divorcuar ose i ve, (sipas certifikatës së gjendjes familjare), por që është në/nën nivelin e pagës minimale , vërtetuar me dokumentacionin përkatës.
8. Fëmijë të familjeve të pakicës rome dhe egjiptiane, sipas vërtetimit përkatës të lëshuar nga organizatat që mbrojnë të drejtat e tyre ose vetë deklarimit ku përcaktohet se familja është pjesë e këtyre pakicave.
9. Fëmijët e vendosur në kujdestari nga familjet kujdestare, sipas legjislacionit në fuqi, vërtetuar me dokumentacionin përkatës.

Neni 67

Mbledhja e tarifës

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve. Të ardhurat kalojnë 100% në llogarinë e Bashkisë Tiranë, sipas akt akordimeve në fund të çdo muaji dhe të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Neni 68

Tarifa për Qendrën “TEN”

1. Tarifa për dhënien në përdorim të sallës së Qendrës TEN është 5000 lekë/ora.
2. Tarifa për përdorimin e sallës së provave për grupet muzikore të jashtëm është 1000 lekë/ora.
3. Për ekspozita në Sallën Galeri Artit Figurativ tarifa është 1.000 lekë/ora
4. Tarifa për konferenca e evente të ndryshme në Sallën e Atriumit të rezervuara për organizata dhe institucione të jashtme është 2.500 lekë/ora
5. Përfshihen nga kjo tarifë vetëm Organizatat Rinore, të cilat zhvillojnë aktivitete në sallën e konferencave dhe sallën Atriumit në bashkëpunim me Qendrën Rinore TEN, si edhe të rinjtë vullnetarë për aktivitete të ndryshme që aktivizohen pranë Qendrës Rinore TEN.

Neni 69

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Qendra Rinore TEN dhe arkëtimi i të ardhurave do të kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, sipas akt akordimeve në fund të çdo muaji të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Të ardhurat kalojnë 100% në llogarinë e Bashkisë së Tiranës.

KREU IX

TARIFA PËR MUZEUN PRANË KULLËS SË SAHATIT

Neni 70

Baza, niveli i tarifës dhe lehtësira

1. Tarifa për hyrjen në Muzeun pranë Kullës së Sahatit” është 200 lekë personi.
2. Përfshihen nga pagesa e kësaj tarife grupet e organizuara të nxënësve të shkollave, pensionistët, veteranët, invalidët e punës e luftës, përfituesit e ndihmës ekonomike, si dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuar sipas përkufizimit të ligjit 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
3. Tarifa e hyrjes për studentet në Muzeun e Kullës së Sahatit është falas. Për të përfituar nga kjo lehtësi, në momentin e pagesës së kësaj tarife studentët duhet të paraqesin kartën e studentit.

KREU X
TARIFA PËR SHËRBIMIN E KARROATRECIT

Neni 71
Niveli i tarifës

Tarifa për shërbimin e karroatrecit është 4.000 lekë për çdo transport mjeti. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, sipas faturës së lëshuar nga Policia Bashkiake.

KREU XI
TARIFA DITORE PËR QËNDRIMIN E AUTOMJETEVE NË PIKAT E BLOKIMIT TË
POLICISË BASHKIAKE

Neni 72
Niveli i tarifës dhe vjelja e saj

Tarifa për qëndrimin e automjeteve në pikat e bllokimit të Policisë Bashkiake është 500 lekë/ditë. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarife është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, sipas faturës së lëshuar nga Policia Bashkiake.

KREU XII
TARIFA PËR PËRDORIMIN E AMBIENTEVE TË SHKOLLAVE PUBLIKE

Neni 73
Baza dhe niveli i tarifës

Tarifat për ambientet e shkollave publike, janë si më poshtë:

1. Për dhënien në përdorim të ambienteve brenda shkollës, si auditor, klasa etj është 5.000 lekë/ora.
2. Përdorimin e ambienteve të palestrës standarde (28 x 13): 500 lekë/ora.
3. Përdorimin e ambienteve të palestrës jo standarde (18 x 9): 350 lekë/ora.
4. Përdorimin e ambienteve të jashtme sportive të shtruara me beton është 300 lekë/ora.
5. Përdorimin e fushave të minifutbollit me bar sintetik është 200 lekë/ora.
6. Mënyra dhe strukturat e ngarkuara për aplikimin dhe arkëtimin e tarifave sipas kësaj pike do të përcaktohen në marrëveshjet që nënshkruhen nga strukturat përkatëse të bashkisë me subjektet apo individët privat që marrin në përdorim këto ambiente.

KREU XIII
TARIFA PËR PAJISJEN ME KARTË STUDENTI

Neni 74
Niveli i tarifës

1. Tarifa e shërbimit për pajisje apo ri pajisje me kartë studenti është 350 lekë. Vlefshmëria e saj përkon me kohëzgjatjen e studimeve.
2. Përfshihen nga pagesa e tarifës së shërbimit për pajisje me kartë studenti të gjithë ata studentë që kanë statusin e invalidit. Për të përfituar nga ky përjashtim, studenti duhet të paraqesë vërtetimin e KMCAP ose librezën e invalidit.

3. Institucioni që prodhon dhe administron kartën e studentit është Agjencia e Rinisë. Të ardhurat e mbledhura nga karta do të përdoren për prodhimin, shpërndarjen e kartës së studentit dhe detaje të tjera që lidhen me këtë proces.

KREU XIV

TARIFA E SHËRBIMIT FUNERAL

Neni 75

Baza dhe niveli i tarifës

1. Tarifat e shërbimit funeral përcaktohen në aneksin nr. 11, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Agjencia e Shërbimeve Funerale. Të ardhurat kalojnë 100% në llogarinë e Bashkisë së Tiranës.

KREU XV

TARIFAT PËR MUZEUN VENDOR “SHTËPIA STUDIO KADARE”

Neni 76

Baza dhe niveli i tarifës

1. Tarifat e hyrjes në muzeun vendor “Shtëpia Studio Kadare” janë si më poshtë:
 - a) Biletë Individuale 500 lekë;
 - b) Biletë Grupi (mbi 10 persona) 300 lekë;
 - c) Biletë Familjare (dy ose më shumë persona) 250 lekë;
 - d) Biletë e reduktuar (pensionistë, veteranë, invalidë pune dhe lufte, ish të përndjekur politikë) 100 lekë;
 - e) Biletë Studenti 80 lekë.

Neni 77

Përjashtime

1. Përjashtohen nga pagesa e tarifës në muzeun vendor “Shtëpia Studio Kadare”, kategoritë e mëposhtme:
 - Nxënës shkolle (nën 18 vjeç)
 - Përfitues të ndihmës ekonomike
 - Të verbër
 - Të sëmurë tetraplegjikë dhe paraplegjikë
 - Personat e tjerë me aftësi të kufizuar sipas përkufizimit të ligjit 93/2014;
 - Delegacione zyrtare shtetërore;
 - Gazetarë
 - Persona të pajisur me kartën ICOM (Këshilli Ndërkombëtar i Monumenteve dhe Siteve).
2. Për të përfutur përjashtimet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, personat, në momentin e hyrjes në muze, duhet të paraqesin dokumentin përkatës që vërteton statusin e tyre.
3. Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është “Shtëpia Studio Kadare”. Të ardhurat kalojnë 100% në llogarinë e Bashkisë së Tiranës.

KREU XVI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 78

Strukturat e ngarkuara për zbatimin e këtij vendimi

1. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Tiranë të miratojë aktet e nevojshme dhe të lidhë marrëveshjet sipas parashikimeve të këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit, Njësitë Administrative, lagjet dhe të gjitha ndërmarrjet dhe institucionet e varësisë që janë objekt i parashikimeve të këtij vendimi.

Neni 79
Shfuqizime

1. Vendimi nr. 59, datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, të ndryshuar, shfuqizohet.
2. Çdo vendim apo parashikim tjetër që bie ndesh me këtë vendim, shfuqizohet.

Neni 80
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2020.

K R Y E T A R

TONI GOGU

Aneksi nr. 1: Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi për Bashkinë Tiranë

Bashkia Tiranë	Nr. Njesisë Administrative	Nr. Rendor	Zona	Lekë/m2 sipërfaqe Shfrytëzimi
Qyteti Tiranë sipas ndarjeve zonale për çdo njësi administrative	1	1	1/1	97 700,00 Lekë
		2	1/2	78 000,00 Lekë
	2	3	2/1	187 000,00 Lekë
		4	2/2	134 500,00 Lekë
		5	2/3	95 000,00 Lekë
		6	2/4	110 000,00 Lekë
		7	2/5	80 000,00 Lekë
	3	8	3/1	77 000,00 Lekë
		9	3/2	60 000,00 Lekë
	4	10	4/1	70 000,00 Lekë
		11	4/2	60 000,00 Lekë
	5	12	5/1	190 000,00 Lekë
		13	5/2	132 000,00 Lekë
		14	5/3	107 000,00 Lekë
		15	5/4	82 000,00 Lekë
	6	16	6	65 000,00 Lekë
	7	17	7/1	120 000,00 Lekë
		18	7/2	100 000,00 Lekë
		19	7/3	85 000,00 Lekë
		20	7/4	65 000,00 Lekë
	8	21	8/1	110 000,00 Lekë
		22	8/2	100 000,00 Lekë
		23	8/3	72 000,00 Lekë
	9	24	9/1	130 000,00 Lekë
		25	9/2	100 000,00 Lekë
		26	9/3	77 000,00 Lekë
	10	27	10/1	145 000,00 Lekë
		28	10/2	139 500,00 Lekë
		29	10/3	102 000,00 Lekë
	11	30	11/1	87 000,00 Lekë
		31	11/2	75 000,00 Lekë
		32	11/3	70 000,00 Lekë
Njësitë Administrative Bashkia Tiranë	12	33	Baldushk	32 000,00 Lekë
	13	34	Bërzhitë	34 000,00 Lekë
	14	35	Dajt	53 500,00 Lekë
	15	36	Farkë	66 500,00 Lekë
	16	37	Kashar	53 500,00 Lekë
	17	38	Krrabë	28 200,00 Lekë
	18	39	Ndroq	34 000,00 Lekë
	19	40	Petrelë	53 500,00 Lekë
	20	41	Pezë	53 500,00 Lekë
	21	42	Shëngjergj	23 000,00 Lekë
	22	43	Vaqarr	34 000,00 Lekë
	23	44	Zall-Bastar	25 000,00 Lekë
	24	45	Zall-Herr	28 200,00 Lekë

Aneksi nr. 2: Taksa mbi tokën bujqësore

Kategoritë e tokës bujqësore	lekë/ha/vit
I	5,600
II	4,900
III	4,200
IV	3,600
V	3,000
VI	2,400
VII- X	1,800

Aneksi nr: 3: Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajshme

Lloji i banesës	Njësia Administrative Tiranë	Njësia Administrative Dajt, Farkë, Kashar, Bërzhitë, Pezë, Baldushkë, Vaqar, Petrelë, Krabë, Ndroq, Shëngjergj, Zall-Herr, Zall-Bastar
I. Ndërtesa banimi	1,000	100
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	2,000	300
III. Ndërtesa të tjera	1,500	200

Aneksi nr. 4: Taksa e tabelës

Nr.	LLOJET E TABELAVE	Njësia matëse	Lekë
I.	Taksë table për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti I biznesit)		
a	deri në 2 m²	lekë/m ² /vit	-
b	mbi 2m² deri 10 m²		
	- e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	15,000
	- me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	20,000
	- elektronike	lekë/m ² /vit	35,000
c	mbi 10 m² deri 20 m²		
	- e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	12,750
	- me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	17,000
	- elektronike	lekë/m ² /vit	29,750
ç	mbi 20 m² deri 40 m²		
	- e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	8,250
	- me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	11,000
	- elektronike	lekë/m ² /vit	19,250
d	mbi 40 m²		
	- e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	6,000
	- me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	8,000
	- elektronike	lekë/m ² /vit	14,000
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim		
	- Tabela identifikuese	lekë/m ² /vit	120
III.	Tabela për qëllime reklamimi e lëvizshmë e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m²		
	- e thjeshtë (me/pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	45,000
	- elektronike	lekë/m ² /vit	90,000
IV.	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj		
	- të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë/m ² /ditë	1,000

Aneksi nr. 5: Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore

Nr.	Taksa e përkohshme e	Niveli i Taksës
-----	----------------------	-----------------

	infrastrukturës arsimore	Viti 2020			
		BV		BM	VIP
		0-2 milionë	2-8 milionë		
		Leke /vit		Leke /vit	Leke /vit
I	Familjaret	1,800			
II	Biznesi				
II.1	Shitje me pakicë	2,500	4,000	15,000	22,000
II.2	Shitje me shumicë	8,000	9,000	27,000	37,000
II.3	Njësi prodhimi	8,000	9,000	27,000	37,000
II.4	Subjekte ndërtimi	8,000	9,000	27,000	37,000
II.5	Njësi shërbimi	2,500	4,000	17,000	32,000
II.6	Shoqata, fondacione, ente të ndryshme, shtetërore, organizata joqeveritar	5,000			
II.7	Profesione të lira	2,500	4,000	15,000	18,000
II.8	Transport	2,500	4,000	11,000	18,000

Nr	Kategoritë	BV		BM	VIP
		Xhiro	Xhiro		
		0-2 mil- ionë	2-8 mil- ionë		
		Leke/vit	Leke/vit	Leke/vit	Leke/vit
	FAMILJARËT (për Familje)				
I	Qyteti Tiranës	5,750			
	NJA = Dajt, Farkë, Kashar,	2,300			
	NJA = Berzhite, Baldushk, Petrele, Vaqarr, Pezë, Ndroq, Krabë, Shengjergj, Zall-Herr, Zall-Bastar	1,150			
II	BIZNESI				
II.1	SHITJE ME PAKICË				
	Mish, peshk	5,750	11,500	92,000	115,000
	Bulmet, fruta, perime, ushqimore	5,750	11,500	69,000	93,150
	Artikujt industrialë (veshje, parfumeri, argjendari, etj të ngjashme me to).	5,750	11,500	34,500	57,500
	Bar kafe	5,750	11,500	69,000	92,000
	Restorant, fast food etj të ngjashme me to	5,750	13,800	85,100	108,100
	Pub, diskoteka etj të ngjashme	5,750	13,800	92,000	115,000
	Kafe internet, lojëra fati, qendra interneti	5,750	11,500	23,000	43,700
	Njësi tregtimi lëndësh djegëse, hidrokarbure etj të ngjashme me to.	5,750	11,500	50,600	73,600
	Shitje produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to (depo farmaceutike të regjistruara si biznes i vogël)	5,750	11,500	23,000	43,700
	Etj të ngjashme me to	5,750	11,500	23,000	43,700
II.2	SHITJE ME SHUMICË				
	Magazina, dyqane, etj të cilat realizojnë shitje me shumice	5,750	13,800	85,100	108,100
II.3	NJËSI PRODHIMI				
	Përpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie letre, kartoni, plasmasi etj të ngjashme me to	5,750	11,500	195,500	414,000
	Prodhim tullat, tjegulla, blloqe betoni, furra gëlqereje, nyje inerte etj, të ngjashme me to	5,750	11,500	195,500	414,000
	Prodhime ushqimore, buke, ëmbëlsirash, mi-shi, peshku, bulmeti, pijesh etj të ngjashme me to.	5,750	11,500	195,500	391,000
	Prodhim konfeksione, etj të ngjashme me to.	5,750	8,050	195,500	414,000
	Prodhim, përpunim vajrash, nafte, gazi e nën-produkte etj të ngjashme me to.	5,750	8,050	195,500	414,000

	Impiante, territore për therrjen e kafshëve etj të ngjashme me to.	5,750	8,050	195,500	414,000
	Shtypshkronja etj të ngjashme me to.	5,750	8,050	195,500	414,000
	Impiante, linja për prodhim dhe përpunim e produkteve ushqimore ose të tjera.	5,750	8,050	195,500	414,000
	Prodhim përpunim produkte farmaceutike etj të ngjashme me to.	5,750	8,050	195,500	414,000
II.4	SUBJEKTE NDËRTIMI				
	Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, objekte banimi, shërbimi, të përbëra etj të ngjashme me to ,	5,750	34,500	345,000	517,500
	Rikonstruksione të pjeseshme	5,750	17,250	172,500	257,600
	Subjekte ndërtuese për selinë administrative	5,750	17,250	41,400	69,000
	Subjektet e Karrierave për prodhim guri, inerte etj të ngjashme me to,	5,750	17,250	115,000	115,000
II.5	NJËSI SHËRBIMI				
	Riparimi i artikujve elektro-shtepiake, radio televizorë, frigoriferë, lavatriçe, magnetofon, paisje fonie e të tjera të ngjashme me to.	4,000	11,500	57,500	69,000
	Shërbime fotokopjimit, sallon bukurie, autoservise, kurse për makina,(autoshkolla) për traktore, për kompjuter e për parukeri, agjensi doganore,agjensi këmbimi valutë, agjensi turizmi,, konviktet pikat e shërbimit të makinave (autoservis), parkimi i makinave, agjenci transporti, lavanteritë,pastrimi kimik, shërbime të rojeve civile, sallat e lojrave të ndryshme,(gjimnastikë, aerobie, cirqe, kënde lojrash për fëmijë, ping pong, etj.) e të tjera shërbime të ngjashme me shërbimet e lartëpërmendura.	4,000	11,500	57,500	80,500
	Shtëpi botuese, biblioteka	5,750	11,500	57,500	80,500
	Hotele, motele (lekë/dhomë në vit)	5,750	11500	34,500	69,000
			1,150	1,725	2,300
	Njësi shërbimi marangoz, rrobaqepës,këpucar, floktore, orëndreqës etj	4,000	8,050	34,500	57,500
	Komplekse sportive, palestra, fitnes,pishina, qendra e institute kërkimore-shkencore,salla koncerte-mbledhje e videoteka	5,750	11,500	57,500	80,500
	Lojra me kompjuter, lojra fëmijësh të hapura dhe të mbyllura	5,750	11,500	23,000	57,500

	Institucionet jopublike të edukimit (shkollat, kopshtet apo çerdhet, shërbimet në klinikat e specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratorë diagnostifikimi	5,750	11,500	57,500	80,500
	Njësi të tjera (që nuk përfshihen në kategoritë dhe nënkategoritë si më lart)	5,750	11,500	34,500	57,500
II.6	SHOQATA, FONDACIONE, ENTE TË NDRYSHME SHTETËRORE, ORGANIZATA JOQEVERITARE	10,000			
II.7	PROFESIONE TË LIRA				
	Avokatët, noter,mjek, mjeku-laborant, stomatologu, farmacisti,ekonomisti kontabël te miratuar, eksperti kontabël te autorizuar, mësuesit, veterinerët, agronomët, botuesit, inxhinier, arkitekti, projektuesi, e të tjera profesione të lira te cilat ushtrohen në njësi fikse apo në ambiente të ndryshme e të tjerë të ngjashëm me to.	5,750	11,500	34,500	57,500
	Galeritë e artit të piktoreve, skulptorëve dhe artistëve të tjerë që prodhojnë dhe tregtojnë objekte artistike	4,000	11,500	34,500	57,500
	Institucionet jopublike të edukimit (shkollat, kopshtet apo çerdhet),shërbimet në klinikat e specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratorë diagnostifikimi etj në rastet kur nuk e kalojnë kufirin e regjistrimit nëTVSH.	5,750	13,800	57,500	80,500
II.8	AMBULANT				
	Subjekte që nuk kanë një vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante në tregje publike dhe private.	3,000			
II.9	TRANSPORT				
	Transport pasagjerësh				
	Automjet deri 5 vende	4,000	8,050	23,000	55,200
	Automjet 6-9 vende	4,000	8,050	23,000	55,200
	Automjet 10-25 vende	4,000	8,050	23,000	55,200
	Automjet 26-42 vende	4,000	8,050	23,000	55,200
	Automjet mbi 42 vende	4,000	8,050	23,000	55,200
	Transport Mallrash				
	Automjet deri 2 tonë	4,000	8,050	23,000	55,200
	Automjet 2-5 tonë	4,000	8,050	23,000	55,200
	Automjet 5-10 tonë	4,000	8,050	23,000	55,200
	Automjet 10-16 tonë	4,000	8,050	23,000	55,200
	Automjet mbi 16 tonë	4,000	8,050	23,000	55,200

Aneksi nr. 7: Tarifa e parkimit

Zonat e Administrimit të Parkimit në qytetin e Tiranës:

1. **Zona 1:** Përfshihet pjesa veri-perëndimore e qytetit, ku kufizohet në lindje me bulevardin ‘Zogu I’ dhe kordonin hyrës me rrugën ‘Llazi Miho’, ‘Konferenca e Pezës’ duke vazhduar përgjatë bulevardit “Gjergj Fishta” në anën jugore deri në ndërprerjen me bulevardin “Dëshmorët e Kombit”.
2. **Zona 2:** Përfshin pjesën perëndimore të bulevardit “Zogu i I”, vijën kufizuese të qytetit në pjesën Veri-Lindore dhe zgjatimin e bulevardit “Zhan Dark” deri në vijën kufizuese në anën Jugore.
3. **Zona 3:** Shtrihet përgjatë anës perëndimore të bulevardit “Dëshmorët e Kombit”, bulevardit “Bajram Curri” dhe përgjatë lumit të Lanës deri në vijën kufizuese në anën veriore dhe pjesën Jug-Lindje të vijës së qytetit të Tiranës.
4. **Zona 4:** Përfshin pjesën veriore të rrugës “Konferenca e Pezës”, vazhdon me bulevardin si vijë kufizuese e qytetit në anën Lindore, zona Lindore përgjatë bulevardit “Dëshmorët e Kombit” dhe vija kufizuese e qytetit në pjesën Jugore.

Gjithashtu zonat janë të ndara sipas tarifave, zona A, zona B dhe zona C.

Zona A:

Përfshihen zona me aktivitete të larta tregtare, financiare, institucionale apo sociale.

a: Tarifa për vendparkim në rrugë: 100 lekë/ora

b: Tarifa për vendparkim në sheshe

Autovetura sipas intervalit të qëndrimit	Tarifa/Lekë
0-5 minuta falas	
0-3 orë	200
3- 8 orë	500
8-12 orë	800
12-24 orë	500

Mungesa e biletës sanksionohet me 3000 lekë gjobë (ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtje administrative”)

c: Tarifat për vendsparkim të rezervuar në rrugë dhe sheshe

Tabela 1- Tarifa për vendparkim të rezervuar në rrugë

Paketa/Abonimi	Orë/Ditë	Ditë/Vit	Total Orë	Tarifa/lekë
kontrata 1 vit (nga e hëna në të premte)	12	264	3168	221,760
kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	24	365	8760	438,000
kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	12	365	4380	306,600
kontrata 1 vit (nga e hëna në të premte)	10	264	2640	198,000
kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	10	365	3650	255,500

Tabela 2- Tarifatat për vendparkim të rezervuar në sheshe

Paketa/Abonimi	Tarifa/lekë
Paketa 1 mujore	12,300
Paketa 3 mujore	35,000
Paketa 6 mujore	67,500
Paketa 12 mujore	132,000

Zona B:

Përfshihen zona me aktivitete me intensitet mesatar tregtar, financiar, institucional apo social, ku qëndrimi në parkim zgjat afërsisht 1- 3 orë.

a: Tarifa për vendparkim në rrugë: 40 Lekë/ora

b: Tarifa për vendparkim në sheshe

Autovetura sipas intervalit të qëndrimit	Tarifa/Lekë
0-5 minuta falas	
0-3 orë	100
3- 8 orë	250
8-24 orë	300

Mungesa e biletës sanksionohet me 1,000 lekë gjobë (ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtje administrative”)

Tabela 1- Tarifatat për vendparkim të rezervuar në rrugë

Paketa/Abonimi	Orë/Ditë	Ditë/Vit	Total Orë	Tarifa/lekë
kontrata 1 vit (nga e hëna në të premte)	12	264	3168	88,704
kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	24	365	8760	175,200
kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	12	365	4380	122,640
kontrata 1 vit (nga e hëna në të premte)	10	264	2640	79,200
kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	10	365	3650	102,200

Tabela 2- Tarifa për vendparkim të rezervuar në sheshe

Paketa/Abonimi	Tarifa/lekë
-----------------------	--------------------

Paketa 1 mujore	5,000
Paketa 3 mujore	14,000
Paketa 6 mujore	27,500
Paketa 12 mujore	53,000

Zona C: Përfshihen zonat në zhvillim ku rrjeti rrugor nuk është shumë i dendur. Kjo zonë shfrytëzohet kryesisht nga rezidentët prandaj dhe nevoja për parkim është krahasimisht më e vogël.

a: Tarifa për vendparkim në rrugë: 20 Lekë/ora

b: Tarifa për vendparkim në sheshe

Autovetura sipas intervalit të qëndrimit	Tarifa/Lekë
0-5 minuta falas	
0-3 orë	50
3- 8 orë	120
8-24 orë	250

Mungesa e biletës sanksionohet me 500 lekë gjobë (ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtje administrative”)

c: Tarifat për vendparkim të rezervuar në rrugë dhe sheshe

Tabela 1- Tarifat për vendparkim të rezervuar në rrugë

Paketa/Abonimi	Orë/Ditë	Ditë/Vit	Total Orë	Tarifa/lekë
kontrata 1 vit (nga e hëna në të premte)	12	264	3168	44,352
kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	24	365	8760	87,600
kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	12	365	4380	61,320
kontrata 1 vit (nga e hëna në të premte)	10	264	2640	39,600
kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel)	10	365	3650	51,100

Tabela 2- Tarifa për vendparkim të rezervuar në sheshe

Paketa/Abonimi	Tarifa/lekë
Paketa 1 mujore	2,500
Paketa 3 mujore	6,600
Paketa 6 mujore	13,000
Paketa 12 mujore	25,000

TARIFAT E PARKIMIT NË STACIONET FUNDORË PROVIZORE

Parkimi i mjeteve në stacionet fundore (provizore) të linjave Ndërqytetëse, Ndërkombëtare dhe të Kosovës të udhëtimit të qytetarëve janë si më poshtë:

Autobuza	Tarifa/Lekë
1 orë	200
1-3 orë	400
3- 8 orë	400
8-24 orë	700

TARIFA E PARKIMIT PËR MJETET TAKSI

Tarifa e parkimit për mjetet e liçensuara taksi në qytetin e Tiranës është në vlerën 27.600 lekë dhe paguhet çdo vit brenda datës 20 Prill të vitit aktual. Në rast se subjektet nuk përmbushin parashikimet e pikës 1 të këtij neni, mbi vlerën e detyrimit llogariten gjoba dhe kamatvonesa referuar Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Aneksi nr. 8: Tarifa për zënien e hapësirës publike

KATEGORIA DHE NËNKATEGORITË	NIVELI TREGUES I TAKSËS/MUAJ			
	Z. A	Z. B	ZONA C Qyteti Tirane, NJA = Dajt, Farke, Kashar	NJA = Berzhite, Baldushk, Petrele, Vaqarr, Peze, Ndroq, Krabe, Shengjergj, Zall-Herr, Zall-Bastar
Zënie e hapësirës publike (përdorim trualli)				
Nënkategoritë				
Organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme	1500 ALL/m ²	750 ALL/m ²	400 ALL/m ²	200 ALL/m ²
Zënia e Hapësirës publike për qëllime biznesi/tregtimi në Tregjet Publike të administruara nga Njësitë Bashkiake.	1500 ALL/m ²	750 ALL/m ²	400 ALL/m ²	200 ALL/m ²
Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi si vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, vendosje tavolinash sipërfaqet e zëna me platforma, sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to.	1500 ALL/m ²	750 ALL/m ²	400 ALL/m ²	200 ALL/m ²

Aneksi nr. 9: Tarifa për shërbimin veterinar

Nr.	Kategoritë e aktiviteteve të kontrollit	Kontrolli	Tarifa e përcaktuar
1	Kontrolli i mishit dhe pajisja me raport veterinar për kre gjedh i rritur, gjedh i ri, (lopë, ka, mëshqerrë, viç	- Vizitimi para therjes.	200 lekë (për çdo kre)
		(gjëndja shëndetësore e kafshës së gjallë)	
		- Kontrolli gjatë dhe pas therjes.	
		(egzaminim dhe vlerësim organo-leptik i karkases)	
		- Vulosja, plotësimi i dokumentacionit veterinar	
2	Kontrolli i mishit dhe pajisja me raport veterinar për një kre bagëti të imta (dash, dele, cja, dhi, derr, ruzja, mitorë, ftuja, tujakë, qingj, kec, gic).	- Vizitimi para therjes.	200 lekë (për çdo kre)
		(gjëndja shëndetësore e kafshës së gjallë)	
		- Kontrolli gjatë dhe pas therjes.	
		(egzaminim e vlerësim organo-leptik i karkasës)	
		- Vulosja, plotësimi i dokumentacionit veterinar	
3	Shërbim veterinar në tregun e gjësë së gjallë	- Rregjistrimi i dokumentacionit shoqërues për çdo bagëti të gjallë.	200 lekë (për çdo kre)
		- Lëshimi i certifikatës për lëvizjen e kafshëve	
4	Kontrolli i mishit dhe pajisja me raport veterinar shpendë	- Vizitimi para therjes.	10 lekë/100 shpend
		- Kontrolli gjatë dhe pas therjes.	
		- Vulosja, plotësimi i dokumentacionit veterinar	

Aneksi nr. 10: Tarifa për shitjen e bimësisë

Nr.Ren dor	Emërtimi	Vitet e pro- dhimit	Tarifa e shitjes/njësi
1	Farishtore lule sezonale (lili- um,kalendula,margarita,vjollca,miozotis)		10
2	Lule sezonale në vazo Ø 10 në vazo,trëndafil, la- vantinë,rozmarinë, abele, asparagus, gerbene, sedum, sanseve- ria, variegata, pehonia, sapunaria,kalemtore		100
3	Sterlicie		250
4	Tulipan		300
5	Kalla, Narciza		150
6	Begoniametalica, begonia rex, begonia gjigande, varëse, Pilea, Mullaga, Klorofitum, lule vathi, Sindapsus, belloperonia, lule bore, lantana, piperonja variegat, tradenscancia, piperonja jeshile, la kukaraca, begonia tuberoza, aspidistra, fieri, saksifraga, hедера jeshile, ekeverja		400
7	Begonisa semperflorens, palma e ujit, Koleus, Gerbena, Dahl- ia, Ceneralia		200
8	Për bimët e mbjella në vazo Ø 40 jashtë sere		1,500
9	Hibiscus, jasemin, bukeville, darville, vinter,liguster,dafinë, evonimus, manjolë, fotinja, pitosphora, bush, inxhi, shegë, muriz, berberis, kerre, hardhi muri, cidonja, spirë	viti I	700
10	Hibiscus, jasemin, bukeville, darville, vinter	viti II	1,000
11	Hibiscus, jasemin, bukeville, darville, vinter	viti III	1,300
12	Hibiscus, jasemin, bukeville, darville, vinter	viti IV	1,500
13	Cedrus, criptomeria, tuja, goldeneres, pishë, selvi jeshile, selvi gri	viti II	1,500
14	Cedrus, criptomeria, tuja, goldeneres, pishë, selvi jeshile, selvi gri	viti III	2,500
15	Cedrus, criptomeria, tuja, goldeneres, pishë, selvi jeshile, selvi gri	viti IV	3,000
16	Julibrisin, mimozë	viti II	2,000
17	Julibrisin, mimozë	viti III	3,000
18	Julibrisin, mimozë	viti IV	5,000
19	Katalba, gingo, gështenjë, panjë, rrap,julibrisinë, mimozë, frashër, bli	viti I	1,500
20	Katalba, gingo, gështenjë, panjë, rrap,	viti II	1,800
21	Katalba, gingo, gështenjë, panjë, rrap, frashër, bli	viti III	2,700
22	Katalba, gingo, gështenjë, panjë, rrap, frashër, bli	viti IV	4,500

23	Bush, inxhi, shegë, murriz, berberis, kerre, hardhi muri, cidonja, spirë, ligustër, dafinë, evonimus, manjolë, fotinia, pitosphora	viti II	900
24	Bush, inxhi, shegë, murriz, berberis, kerre, hardhi muri, cidonja, spirë, ligustër, dafinë, evonimus, manjolë, fotinia, pitosphora	viti III	1,200
25	Bush, inxhi, shegë, murriz, berberis, kerre, hardhi muri, cidonja, spirë, ligustër, dafinë, evonimus, manjolë, fotinia, pitosphora	viti IV	1,600
26	Frashër, bli	viti II	1,800
27	Azale, palm. feniks, palm. camerops, sterlicie, asparagus spreng, dhe plumoz, ciklamin, kordelinia, klivia, amarilus, fitonias, cipus, capelassa, filadelfia, kroton, abutilion, euforbia, fikus, monstera, arale, aukuba, juka	viti I	250
28	Azale, palm. feniks, palm. camerops, sterlicie, asparagus spreng, dhe plumoz, ciklamin, kordelinia, klivia, amarilus, fitonias, cipus, capelassa, filadelfia, kroton, abutilion, euforbia, fikus, monstera, arale, aukuba, juka	viti II	500
29	Azale, palm. feniks, palm. camerops, sterlicie, asparagus spreng, dhe plumoz, ciklamin, kordelinia, klivia, amarilus, fitonias, cipus, capelassa, filadelfia, kroton, abutilion, euforbia, fikus, monstera, arale, aukuba, juka	viti III	800
30	Azale, palm. feniks, palm. camerops, sterlicie, asparagus spreng, dhe plumoz, ciklamin, kordelinia, klivia, amarilus, fitonias, cipus, capelassa, filadelfia, kroton, abutilion, euforbia, fikus, monstera, arale, aukuba, juka	viti IV	1,000
31	Plep, plep kavak,shelg,lot,shelgvimin,langestronia, oleandër,lonicere,gledice, cetrus, criptomeria, tuja, golden eneres, pishë, selvi jeshile, selvi gri	viti I	1,000
32	Plep, plep kavak,shelg,lot,shelgvimin,langestronia, oleandër,lonicere,gledice	viti II	2,500
33	Plep, plep kavak,shelg,lot,shelgvimin,langestronia, oleandër,lonicere,gledice	viti III	3,400
34	Plep, plep kavak,shelg,lot,shelgvimin,langestronia, oleandër,lonicere,gledice	viti IV	5,000
35	Plep, plep kavak,shelg,lot,shelgvimin,langestronia, oleandër,lonicere,gledice	viti V	5,500
36	Plep, plep kavak,shelg,lot,shelgvimin,langestronia, oleandër,lonicere,gledice	viti VI	6,500
37	Plep, plep kavak,shelg,lot,shelgvimin,langestronia, oleandër,lonicere,gledice	viti VII	7,000
38	Plep, plep kavak,shelg,lot,shelgvimin,langestronia, oleandër,lonicere,gledice	viti VIII	8,000

Aneksi nr. 11: Tarifa e shërbimit funeral

Nr	Emërtimi	Qyteti Tiranës	NJA = Dajt, Farkë, Kashar	NJA = Bërzhitë, Baldushk, Vaqarr, Petrelë, Pezë, Ndroq, Krabë, Shëngjergj, Zall- Herr, Zall-Bastar
			(-20 %)	(-50%)
1	Tarifa për një shërbim varrim për të rritur	24,000	19,200	12,000
2	Tarifa për një shërbim varrim për të rritur varr mbi varr	27,000	21,600	13,500
3	Tarifa për një shërbim varrim për të mitur (Arkivol+ autofunebër)	19,000	15,200	9,500
4	Tarifa për një shërbim varrim për të mitur i thjeshtë	9,000	7,200	4,500
5	Tarifa shërbimi për mirëmbajtje të veçantë Varri (larje varri, ujitje lule)	150	150	150

